



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1871/18 prot.

Datë 02.10.2024

V E N D I M
Nr. 1377/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.10.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Xh&Miller” SHPK & “Arena MK” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-08222-06-05-2024 me objekt: “Supervizion punimesh për objektin: Ndërtimi i linjës së dërgimit Depo Lis, Burrel, Faza II”, me fond limit 4,289,801.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, me NIPT L51825011V dhe adresë: Rruga e Kavajës, ish-Parku, pranë "Tregut 100 Vitrinat", Kulla C, Shkalle 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A
Lagjja Minatori, Pallati i Kulturës, Bulqizë

Subjekte të Interesuara: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Xh-Miler” SHPK & “Arena MK” SHPK, përfaqësuar nga

operatori ekonomik “Xh&Miler” SHPK me NIPT K72105003E dhe adresë: Njësia bashkiake nr.5, Bulevardi “Gjergj Fishta”, pallati te ish Ekspozita Shqipëria Sot (pranë QPZ), Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 06.06.2024, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-08222-06-05-2024 me objekt: “Supervizion punimesh për objektin: Ndërtimi i linjës së dërgimit Depo Lis, Burrel, Faza II”, me fond limit 4,289,801.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër SH.A.

II.2. Në datën 18.06.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 03.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

GB Civil Engineering	3,613,518.51	Kualifikuar
HTS Company	3,746,849.38	Kualifikuar
Hydro-Eng Consulting	3,613,519.50	Kualifikuar
Net Group	3,613,519.00	Kualifikuar
Novatech Studio	3,613,519.51	Skualifikuar
BOE “Xh-Miller& Arena MK”	3,613,518.50	Kualifikuar

II.4. Në datën 03.07.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 09.07.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4313, si dhe nr. protokollit 1871/2024, datë 09.07.2024, i operatorit ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Xh&Miller” SHPK & “Arena MK” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1871/2, datë 10.07.2024.

II.7. Me shkresën nr. 917 prot, datë 10.07.2024 me objekt: “*Përcjellje dokumentacioni*”, protokolluar me tonën me nr. 1871/3 prot, datë 12.07.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, urdhrin për pezullimin e procedurës objekt - ankimi, si dhe urdhrin për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesës.

II.8. Njëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, me shkresën nr.499/9 prot., datë 15.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1871/4 prot., datë 18.07.2024, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin e KSHA lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK. Referuar vendimit të KSHA-së, rezulton se kjo e fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj. Të njëjtin informacion autoriteti kontraktor e ka përcjellë edhe njëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.948 prot., datë 16.07.2024, protokolluar me tonën me nr.1871/5 prot., datë 18.07.2024.

II.9. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me vendimin e ndërmjetëm 1253/2024 datë 17.09.2024, vendosi të thërrasë ekspertin e fushës, për të verifikuar nëse përllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.354 datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

II.10. Vendimi i ndërmjetëm i KPP-së nr. 1253/2024, datë 17.09.2024, iu komunikua operatorit ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK, me qëllim bërjen e pagesës për kryerjen e akt - ekspertimit nga eksperti i fushës, autoritetit kontraktor, si dhe ekspertit Elidon Kallaverja.

II.11. Me shkresën e datës 23.09.2024, protokolluar me tonën me nr.1871 prot., datë 23.09.2024, operatori ekonomik ankimues ka depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik formularin e ankesës, argumentim si dhe mandat - pagesën, e cila vërteton kryerjen e pagesës në llogarinë e ekspertit Elidon Kallaverja, në zbatim të vendimit nr. 1253/2024 datë 17.09.2024 të KPP-së.

II.12. Me shkresën nr.1484 prot., datë 20.09.2024, me objekt “*Pretendimet e autoritetit kontraktor lidhur me ekspertizën e posacme për përllogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale të fondit limit për procedurën.....*” protokolluar me tonën me nr.1871/10 prot., autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik pyetje drejtuar ekspertit.

II.13. Me shkresën nr.1871/12 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i ka dërguar ekspertit Elidon Kallaverja, pyetjet që shtrohen për zgjidhje nga ana e tij, lidhur me procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht ekspertit i janë parashtruar këto pyetje:

1. *A është përllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?*

2. Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtimi i linjës së dërgimit Depo Lis, Burrel, Faza II” me fond limit 425,375,155 lekë pa TVSh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” ?

II.14. Në zbatim të vendimit nr. 1253/2024 datë 17.09.2024 të KPP-së, me shkresën e datës 26.09.2024, me objekt “Raport ekspertizë” protokolluar me tonën me nr.1871/13 prot., datë 27.09.2024, eksperti ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, raportin lidhur me procedurën objekt - ankimi. Nga shqyrtimi i këtij raporti, Komisioni konstatoi, se akti i ekspertimit nuk ishte i nënshkruar nga eksperti.

II.15. Me shkresën nr.1871/14 prot, datë 30.09.2024, Komisioni i është drejtuar ekspertit, për paraqitjen e aktit të ekspertimit të nënshkruar prej tij.

II.16. Nëpërmjet shkresës nr. prot., datë 26.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 1871/15 prot., datë 30.09.2024, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresa “Raport ekspertizë” e ekspertit Elidon Kallaverja, nënshkruar prej tij, në të cilën ndër të tjera citohet si më poshtë vijon:

“ [...] Sa më sipër konkludojmë në përgjigje të kërkesave nga KPP

I-A është përllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?

Vlera e shpallur prej 4,289,801 leke Pa TVSH është 0.16 leke me pak se përllogaritja e fondit maksimal nga të dhenat e mësipërme.

Në gjykimin tim kjo diferencë nuk ndikon në cenimin e garës mes operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

2.- Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtimi i linjës së dërgimit Depo Lis, Burrel, Faza II” me fond limit 425,375,155 lekë pa tvsh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” ?

KUFIRI MINIMAL i shërbimit të supervizionit sipas përllogaritjes rezulton : **3,613,518.50 lekë pa TVSH**

KUFIRI MAXIMAL i shërbimit të supervizionit sipas përllogaritjes rezulton : **4,289,801.16 lekë pa TVSH**

II.17. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK se: *“vlera e ofertuar dhe shpallur fituese, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Xh&Miller” SHPK & “Arena MK” SHPK, është përlllogaritur (rrumbullakosur) gabim nga komisioni i vlerësimit të ofertave, duke rezultuar nën vlerën minimale të lejuar, bazuar në VKM nr. 354 datë 11.05.2016”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik, për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me vendimin e ndërmjetëm nr.1253/2024 datë 17.09.2024, vendosi të thërrasë ekspertin e fushës, për të verifikuar nëse përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016, *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”*.

III.1.2. Me shkresën nr. 1871/12 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i ka dërguar ekspertit Elidon Kallaverja, pyetjet që shtrohen për zgjidhje nga ana e tij, lidhur me procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht ekspertit i janë parashtruar këto pyetje:

- 1. A është përlllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?*
- 2. Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtimi i linjës së dërgimit Depo Lis, Burrel, Faza II” me fond limit 425,375,155 lekë pa TVSh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” ?*

III.1.3. Nëpërmjet shkresës nr. prot., datë 26.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 1871/15 prot., datë 30.09.2024, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresa *“Raport ekspertizë”* e ekspertit Elidon Kallaverja.

III.1.4. Në nenin 2 *“Qëllimi”* të ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Komisioni konstaton, se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK kanë të bëjnë përkatësisht me vlerën e ofertuar dhe shpallur fituese, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Xh&Miller” SHPK & “Arena MK” SHPK, vlerë e cila sipas tij është përlllogaritur (rumbullakosur) gabim nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duke rezultuar nën vlerën minimale të lejuar, bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016. Sikundër pasqyruar më sipër, për një shqyrtim sa më të drejtë dhe transparent të pretendimeve të palës ankimuese, KPP gjykoi të nevojshme, të thërrasë ekspertin e fushës, për të verifikuar nëse përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.354 datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe të përlllogarisë kufirin minimal dhe maksimal të shërbimit të supervizimit, për procedurën e prokurimit “Ndërtimi i linjës së dërgimit Depo Lis, Burrel, Faza II”, me fond limit 425,375,155 lekë pa TVSh,

referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Referuar “Raport ekspertizës” së ekspertit Elidon Kallaverja, me shkresën e datës 26.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 1871/15 prot., datë 30.09.2024, ka rezultuar se :

“ [...] Sa më sipër konkludojmë në përgjigje të kërkesave nga KPP

I-A është përlllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?

Vlera e shpallur prej 4,289,801 leke Pa TVSH është 0.16 leke me pak se përlllogaritja e fondit maksimal nga të dhenat e mësipërme.

Në gjykimin tim kjo diferencë nuk ndikon në cenimin e garës mes operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

2.- Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtimi i linjës së dërgimit Depo Lis, Burrel, Faza II” me fond limit 425,375,155 lekë pa TVSh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” ?

KUFIRI MINIMAL i shërbimit të supervizionit sipas përlllogaritjes rezulton : **3,613,518.50 lekë pa TVSH**

KUFIRI MAXIMAL i shërbimit të supervizionit sipas përlllogaritjes rezulton : **4,289,801.16 lekë pa TVSH**

Referuar dispozitës ligjore në fushën e mbikëqyrjes, konkretisht VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, KPP sqaron, se autoriteti kontraktor për përlllogaritjen e fondit për shërbimet e parashikuara të kërkuara në dokumentet e tenderit dhe më tej për vlerësimin e ofertave të paraqitura, duhet të ketë në konsideratë hapat e parashikuar, në varësi të kategorisë dhe grupit tarifor si dhe fondit të procedurës së punës që është kërkuar për t’u realizuar ky shërbim, ku bën pjesë objekti i prokurimit.

Referuar “Raport ekspertizës” së ekspertit Elidon Kallaverja, ky i fundit ka konfirmuar se **KUFIRI MINIMAL i shërbimit të supervizionit sipas përlllogaritjes rezulton : **3,613,518.50 lekë pa TVSH** për procedurën e prokurimit “Ndërtimi i linjës së dërgimit Depo Lis, Burrel, Faza II” me fond limit 425,375,155 lekë pa TVSh, referuar VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. KPP konstaton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Xh-Miler” SHPK & “Arena MK” SHPK, ka paraqitur në SPE Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, ku ka deklaruar se çmimi i ofertës pa TVSH është 3,613,518.50 lekë, vlerë e cila është sa minimumi i lejuar për shërbimin e supervizimit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, referuar “Raport ekspertizës” së ekspertit , raport i cili është hartuar referuar VKM nr. 354**

datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Sa më sipër konstatuar, Komisioni vlerëson, se oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Xh-Miler” SHPK & “Arena MK” SHPK në vlerën 3,613,518.50 lekë pa TVSh është e rregullt, e për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndtushuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-08222-06-05-2024 me objekt: “Supervizion punimesh për objektin: Ndërtimi i linjës së dërgimit Depo Lis, Burrel, Faza II””, me fond limit 4,289,801.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

